



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 665/2 Prot.

Tiranë, më 19.04.2019

V E N D I M

Nr. 21 datë 19.04.2019

**MBI SHTESA NË VENDIMIN NR. 12 DATË 08.02.2019 "MBI MIRATIMIN E
STUDENTËVE TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE QË
PËRJASHTOHEN 50% NGA TARIFA E SHKOLLIMIT,
NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS"**


Mbështetur në nenin 49 të Ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të VKM nr.780 dt. 26.12.2018 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimeve në programet e ciklit të dytë të studimeve, në IAL Publike", Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 4 datë 11.01.2019 dhe në Relacionin përkatës, Bordi i Administrimit në mbledhjen e tij të datës 19.04.2019,

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën e studentëve që ndjekin studimet në ciklin e dytë të studimeve, program i parë, në Universitetin e Sporteve të Tiranës dhe plotësojnë kriteret për tu përjashtuar 50% nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2018-2019, shtojca 1 bashkëngjitur:
2. Studentët që ndjekin studimet në ciklin e dytë të studimeve në Universitetin e Sporteve të Tiranës, që kanë paraqitur dokumentacionin dhe nuk plotësojnë kriteret nuk përjashtohen 50% nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2018-2019, shtojca 2 bashkëngjitur :
3. Ky vendim dërgohet në MASR bashkë me listën e studentëve që përjashtohen 50% nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2018-2019.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve, Dega e Informacionit Studentor dhe Regjistrimeve, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe në portalin e transparencës.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT


Vladimir Gjoni



Shtojca 1:

Lista e studentëve që ndjekin studimet në ciklin e dytë të studimeve, program i parë, në Universitetin e Sporteve të Tiranës dhe plotësojnë kriteret për tu përjashtuar 50% nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2018-2019.

Kriteri 2 – Studentë që vijnë nga shtresa sociale : Student fëmijë të personave/familjes me aftësi të kufizuar, të vërtetuar me Vendim të KMCA-së për punë, familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë nga Ligji nr.9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, ndihmën ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë vetëqeverisjes vendore.

Nr.	Emër Mbiemër	Nr. prot	Data	Fakulteti	Viti
1	D H	118/7 410	22/1/2019 25/2/2019	FSHL	MP-2

Kriteri 9. Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët romë / ballkano – egjiptianë.

Nr.	Emër Mbiemër	Nr. prot	Data	Fakulteti	Viti
1	F M	410/1	27/1/2019	FSHL	MP-1

Kriteri 10 ---Student që vjen nga shtresa sociale: Studentë fëmijë të ish- të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie.

Nr.	Emër Mbiemër	Nr. prot	Data	Fakulteti	Viti
1	E N	118/32	12/2/2019	FSHL	MP-2
2	A M	462	6/3/2019	FSHL	MP-1
3	F S	462/1	18/3/2019	FSHL	MP-1

Shtojca 2

Lista e studentëve që ndjekin studimet në ciklin e dytë të studimeve në Universitetin e Sporteve të Tiranës, nuk përjashtohen 50% nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2018-2019,

Kriteri 2 – Studentë që vijnë nga shtresa sociale: studentë fëmijë të personave/familjes me aftësi të kufizuar, të vërtetuar me Vendim të KMCA-së për punë, familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë nga Ligji nr.9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, ndihmën ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë vetëqeverisjes vendore.

Nr.	Emër Mbiemër	Nr. prot	Data	Fakulteti	Viti	Shënime
2	J G	118/8 462/2	22/1/2019 21/3/2019	FSHL	MP-1	Dokumentacioni për verifikim

Kriteri 4- Student që vjen nga shtresa sociale: Student deri në moshën 25 vjeç, që kanë vetëm njërin nga prindërit, pasi prindi tjetër është ndarë nga jeta, ne të ardhurat vjetore të familjes të pamjaftueshme për përballimin e kostos së studimeve.

Nr.	Emër Mbiemër	Nr. prot	Data	Fakulteti	Viti	Shënime
1	M R	118/27 118/31	7/2/2019 11/2/2019	FSHL	MP-1	Mungon dokumentacioni mbi të ardhurat e pamjaftueshme